



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:185135  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05765016

**C.nr.2113/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit K.B. nga Komuna e P., të cilin e përfaqëson F.B., avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P..”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, në seancën e datës 29.05.2024 mori ndërsa me datën 31.05.2024 përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit K.B. nga Komuna e P., e parashtruar me datë 20.08.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P..”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar av. F.B., me datë 20.08.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “P..”, me seli në Prishtinë, baza juridike zhdëmtim sipas autopërgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

Gjykata, me datën 29.05.2024 ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra palë në procedurë, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, përkatësisht nga fletëkthesat e kthyer gjykatës, ku shihet qartë se pala paditëse përkatësisht i autorizuari i tij ftesën për seancën e datës 29.05.2024 e ka pranuar me datën 13.05.2024, dhe po ashtu edhe pala e paditur ftesën e tillë e ka pranuar me datën 18.05.2024, por që në seancë nuk kanë prezantuar dhe mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit”*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezultojnë

se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2113/21, me datë 31.05.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.